

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	00 Nr.Br. 131/2022	Data: Datum: 26.09.2022	

Data 03.10.2022
 Datum

Kuvendi i Komunës së Istogut në bazë të nenit 40.2 pika b) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008) si dhe Ligji nr. 07/l-014 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit me nr.07/l-001 Mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, dhe nenit 33.1 pika 2. të Statutit të Komunës 01Nr.62/10, në mbledhjen e mbajtur më: 26.09.2022, shqyrtoi dhe miratoi propozimin Kryetarit të Komunës Transferin nga Kategoria Ekonomike, 38-Rezerva në Kategorinë Ekonomike, 30-Shpenzime Kapitale, dhe merre këtë:

V E N D I M PËR TRANSFERIN E MJETEVE BUXHETORE TË MBETURA NGA REZERVAT

Miratohet propozimi i Kryetarit të Komunës për transfer të mjeteve në kategorinë Ekonomike Rezerva në Kategorinë Ekonomike Kapitale.

Duke u bazuar në Ligjin e Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2022-2024, Tabela 4.1 Plani i ndarjeve buxhetore të shpenzimeve totale të Komunës së Istogut për vitin 2022, në Kategorinë ekonomike Rezerva, ka rezultuar shuma prej 1,586,645.00€, nga të cilat shuma prej 1,186,645.00 € janë bartur pjesërisht në mbledhjen e Kuvendit me 31.05.2022, ndërsa shuma e mbetur për bartje është 400,000.00€, që duhet të transferohen në kategorinë ekonomike Shpenzime Kapitale, në projektet si në vijim:

I. Transfer i mjeteve nga rezerva

Nga nën-programet buxhetore nga burimi i financimit 10 shuma prej 265,000 €:

- 1) 16317 – Administrata, shuma prej 130,000 €, nga të cilat shuma prej 20,000 €, është në këtë nën-program, ndërsa shuma prej 100,000 €, transferohen nga programi Planifikimi Urban dhe Mjedisi me kod 620, nën-programi Planifikimi Hapësinor dhe Rregullativ-Istog me kod 66090, si dhe shuma prej 10,000 €, transferohen nga programi Zyra e Komuniteteve me kod 195, nën-programi Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim- Istog me kod 19585.

- 2) 18017 - Infrastruktura rrugore, shuma prej: 90,000 €, nga të cilat shuma prej 30,000 €, është në këtë nën-program, ndërsa shuma prej 24,000 € transferohen nga programi Zyra e Komuniteteve me kod 195, nën-programi Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim- Istog me kod 19585, si dhe shuma prej 36,000 € transferohen nga programi Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me kod, 470 nën-programi Bujqësi – Istog me kod 47017;
- 3) 48017- Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik, shuma prej: 45,000€, nga të cilat shuma prej 10,000 €, transferohen nga programi Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me kod, 470 nën-programi Bujqësi – Istog me kod 47017, shuma prej 30,000 €, transferohen nga programi Arsim dhe Shkencë me kod 912, nën-programi Arsim i Mesëm, me kod 94680; si dhe shuma prej 5,000 €, transferohen nga programi Shëndetësia dhe Mirëqenia Sociale me kod 721, në nën-programin Shërbimet e Kujdesit Primar Shëndetësor me kod 74000.

II. Transfer i mjeteve ne kategorinë e shpenzimeve kapitale

Në nen programet buxhetore (burimi i financimit 10):

Në kuadër të programit Administrata dhe Personeli me kod 180, nën-programi Administrata – Istog me kod 16317, shuma prej 130,000 €, transferohen në këtë projekt:

- 1) “Blerja e veturave për nevojat e Administratës Komunale “ kodi (i ri) në shumë prej 130,000 €.

Në kuadër të programit Shërbimet Publike, Mbrojtja Civile, Emergjencia me kod, 180 nën-programi Infrastruktura Rrugore – Istog me kod 18017, shuma prej 90,000 €, transferohen në këto projekte:

- 1) “Ndërtimi i ndriçimit publik në Trubohoc rruga Sylë Çeta” kodi (i ri) në shumë prej 45,000.00€,
- 2) “Ndërtimi i ndriçimit publik Vrellë-Studenicë shkolla” kodi (i ri) në shumë prej 45,000.00€.

Në kuadër të programit Zhvillim ekonomik me kod 470, nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik– Istog me kod 48017, transferohen shuma prej 45,000 € në këto projekte:

- 1) “Ndërtimi i rrugës "Idriz Nekaj" në Shushicë të Ulët” kodi (i ri) në shumë prej 45,000.00€.

Nga nën-programet buxhetore nga burimi i financimit 21 shuma prej 135,000 €:

- 1) 48017- Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik, shuma prej: 135,000 €, nga të cilat shuma prej 80,000 €, transferohen nga programi Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me kod, 470 nën-programi Bujqësi – Istog me kod 47017, shuma prej 15,000 €, transferohen nga programi Kulturë, Rini dhe Sport me kod 0820, nën-programi Shërbimet Kulturore, me kod 85017; si dhe shuma prej 40,000 €, transferohen nga programi Arsim dhe Shkencë me kod 912, nën-programi Arsimi Fillor, me kod 93480.

Në kuadër të programit Zhvillim ekonomik me kod 470, nën-programi Planifikimi dhe Zhvillimi Ekonomik- Istog me kod 48017, transferohen shuma prej 45,000 € në këto projekte:

- 1) “Ndërtimi i rrugës "Idriz Nekaj" në Shushicë të Ulët” kodi (i ri) në shumë prej 69,000€;
- 2) “Ndërtimi i rrugës "Dëshmorët Salihaj" në Shushicë të Ulët” kodi (i ri) në shumë prej 13,000.00€;
- 3) “Ndërtimi i rrugës së varrezave në Gurrakoc” kodi (i ri) në shumë prej 35,000€;
- 4) “Ndërtimi i rrugës Uniteti në Zallq” kodi (i ri) në shumë prej 18,000€.

- I. Autorizohet Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Zyrtari Kryesor Financiar që më planin e Rishikimit të buxhetit komunal të njoftojë Ministrinë e Ekonomisë dhe Financave për procedim të mëtejshëm në pajtim me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësi.
- II. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdesën: Kryetari i Komunës dhe Kryesuesi i Kuvendit të Komunës.
- III. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Departamenti i Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës, Departamenti i Përgjithshëm i Thesarit në Prishtinë, Kryetari i Komunës, Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF) dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.


Kryesuesi i Kuvendit,
z. Enver Rugova
Enver Rugova